

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ KARBURANT PER MAKINAT E SHOQERISE ”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,532,560 (nje milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtedhjetë) leke pa tvsh.
Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor TEC-VLORE,ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi ligjor: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar
si dhe nenit

.....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- **Argumentimi i AK :** Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
-

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme. Vlera totale e kërkuar duhet të jete në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), si dhe te nenit 43 pika 1,2,3,4,6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentimi i AK: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën dhe për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.2.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 (*Për menaxhimin e cilësisë, e vlefshme*) ose ekuivalente me to, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme datën e hapjes së ofertave;

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën perkatese për tregtim karburantesh lëshuar nga organet përkatëse.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport-analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kriteri për paraqitje Fletë-Analizë për produktet e kërkuara është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel”.

Argumentimi ligjor: VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar neni 40 Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 6 c.

2.3.4 Subjekti Ofertues duhet te kete te pakten 2 (dy) pika shperndarjeje te karburantit ne qytetin e Vlores. Kjo kërkesë duhet vertetuar me një nga format e disponimit, sipas Kodit Civil (kontratë qiraje, kontratë furnizimi (bashkëpunimi) ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin tregtar të shoqërisë etj).

Argumentimi: Duke qenë se Termocentrali i Vlores disponon mjete te cilat kryejne aktiviteti ne qytetin e Vlores, është e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 2 (dy) pika të tregtimit me pakicë të karburantit, me qëllim furnizimin e mjeteve efektive të tij.

Argumentojmë se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, brenda afatit te percaktuar per zhvillimin e tenderit, duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Të deklaroje se merr përsipër furnizimin ne stacione te shitjes se karburanteve me pakice çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.

- Te deklarohese realizon sherbimin e kerkuar nepermjet kartes elektronike, ose te disponoje programe me ane te te cilave vertetohet realizimi i levrimit te mallit nepermjet kartes elektronike, bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“, Operatorët ekonomik pjesëmarres duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburantëve (wwweb page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.

- Të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë në lëng të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në magazinën elektronike dhe kartën elektronike të personalizuar te automjetit, deri në përfundimin e plotë të furnizimit te kontraktuar, sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme gjate gjithë kohes deri në përfundimin e plotë të kontratës.

- Të deklarojë qe merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitet e qeverisjes së përgjithshme”, ... etj.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi i specifikime teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm ULSD) dhe Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm) është bërë në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj”.

Argumentimi ligjor: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, dhe 36 pikat 1,2,3,4 të ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 1 dhe 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar për objektin: ‘Blerje karburanti diesel (Gazoil 10ppm) Specifikimet teknike janë në përputhje me standartin shtetëror: **S.SH.EN 590:2022**(ose ekuivalent), sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri. Specifikimet teknike dhe termat e references të pasqyruara në shtojcën 6 të DST, janë hartuar nga specialistet e Tec Vlore sipas nevojave të AK.